



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2022:034034  
Datë: 30.01.2024  
Numri i dokumentit: 05258653

AA.nr.50/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrativ, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Ramiz Kuqi kryetar i kolegjit, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, në çështjen e konfliktit administrativ sipas padisë së paditëses, A... S.... nga Gjakova, të cilat me autorizim i përfaqëson, K... B..., avokat nga Gjakova, kundër të paditurës, Komuna e Gjakovës, për shkak të anulimit të vendimit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative A.nr.345/2022 të datës 22.12.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë;05.01.2024 merr këtë,

**A K T V E N D I M**

Miratohet si e bazuar ankesa e të paditurës - Komuna e Gjakovës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.345/2022 i datës 22.12.2022, priset, dhe lënda i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.345/2022, të datës;22.12.2022, në pikën I të dispozitivit është aprovuar si e bazuar kërkesë padia e paditëses A... S... nga Gjakova, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës. Në pikën II të dispozitivit është anuluar vendimi i të paditurës Komuna e Gjakovës Nr.01-070/01-946 i datës 25.01.2022 dhe çështja i është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje organit të paditur.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura përmes përfaqësuesit të saj, ka ushtruar ankesë, me të cilin konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës të anuloi aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrativë, duke e kthyer çështjen në gjykatën e shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të kundërshtuar në pajtim me nenin 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative lidhur me

nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se, ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, me datë;14.02.2022, ka ushtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, për anulimin e vendimit të paditurës Komuna e Gjakovës Nr.01-070/01-946 të datës 25.01.2022.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditëses, paraqitur kundër të paditurës, jashtë seance e ka aprovuar padinë e paditëses si të bazuar, me arsyetim se vendimi i kundërshtuar është juridikisht i paqartë dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij, i njëjti nuk përmban elementet nga neni 47 dhe 48 të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative, ligj ky i aplikueshëm në periudhën e kundërshtimit dhe shqyrtimit të çështjes pran organit administrativ. E ku Gjykata e shkallës së parë kishte parasysh se ankesa e datës 17.01.2022 e cila është refuzuar më vendimin e atakuar referohet në kundërshtimin e vendimit të datës 12.01.2022 me pretendimin se i është shkelur e drejta e ushtrimit të detyrës së drejtorit të Institucionit “G... T...” Gjakovë. E që vendimi i atakuar me padi fillimisht në dispozitivin e tij referohet në lënien në fuqi të vendimit të datës 21.01.2022 DKA-Gjakovë, e i cili vendim i atakuar i shkallës së parë me ankesë nuk mbanë një datë të tillë por mbanë datë 12.01.2022, andaj edhe nëse kemi një referim gabim të datës nga këtu e paditura nuk konstatohet një korrigjim i tillë i dispozitivit, kurse ky referim në vendim të shkallës së parë të datës 21.01.2022 referohet edhe në arsyetimin e vendimit. Po ashtu i tërë arsyetimi i vendimit i referohet vazhdimit të kontratës, e që në rastin e pretendimeve si në ankesë ato adresohen për pozitën e ushtruesit të detyrës për drejtoreshë të Institutit parashkollorë “G... T...”, andaj në këtë kuptim e paditura arsyetimin e saj e referon në vazhdimin e kontratës, duke mbështetur arsyetimin në vendimin e komisionit disiplinorë e duke mos dhënë arsye lidhur me vendosjen për ankesën e që referohet në ankimimin për ushtrues të detyrës për Drejtor të shkollë. E paditura në vendimin e atakuar thekson se vendimi i datës 21.01.2022 është i bazuar, nxjerrja e tij është bërë pas trajtimit, analizimit dhe shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe provave në dispozicion, e që për Gjykatën e shkallës së parë fillimisht e paditura vendimin e saj nuk e bazon në asnjë provë të administruara, nuk referon se cilat ishin ato prova në të cilat ka mbështetur vendimin dhe po ashtu cilat ishin ato prova të cilave nuk ju fali besimin e paditura. Edhe sikur vendimi i datës 21.01.2022 i referuar në arsyetimin e vendimit të atakuar të nënkuptonte se është referuar gabim data dhe kemi të bëjmë me vendimin e datës 12.01.2022, ky vendim nuk përmban asnjë provë të administruar e në të cilat referohet e paditura se është marrë vendimi i shkallës së parë pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës dhe provave veç e veç, andaj për Gjykatën e shkallës së parë është e pa argumentuar se cilat janë ato prova në të cilat është mbështetur organi i shkallës së parë e të cilat i ka referuar shkalla e dytë si të analizuar dhe mbi bazë e të cilave edhe konstaton se vendimi i shkallës së parë është i mirë bazuar. Gjykata e shkallës së parë kishte përsysh edhe afatin kohor të përcaktuar nga e paditura në këshillën juridikë si afat 15 ditor për inicimin e kontestit të punës në Gjykatën kompetente, duke rënë kështu në kundërshtim me dispozitën ligjore për inicimin e padisë në afat prej 30 ditësh që nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës, afat ky i përcaktuar me nenin 27 par 1 të LKA-së, andaj Gjykata e shkallës së parë nuk mund të bazoj vendimin e vet në konstatime të këtu të paditurisë përderisa nuk ka ofruar prova konkrete, po ashtu nuk ja ka dhënë mundësin paditësit të deklarohet lidhur me një referim të tillë. Në këtë kuptim vendimi është në kundërshtim me nenin 48 të LPPA .

Në këtë kuptim gjykata e shkallës së parë ka gjetur se referuar konstatimeve të bërë në vendimin kontestues, si dhe pretendimeve të palës paditëse, e paditura në kuptim të nenit 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nuk ka arsyetuar shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palës paditëse. Po ashtu nga vendimi i atakuar është konstatuar se i njëjti

nuk përmban asnjë referim ligjore lidhur me çështjen, arsyetimi nuk përmban bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret, i njëjti referon dispozita nga UA nr.151-2020 në lidhshmëri me vazhdimin e kontratës e që në rastin konkreti ankimimi ka të bëjë me pozitën e ushtruesit të detyrës. Sa i përket kontestit lidhur me vazhdimin e kontratës nga palët ndërgjyqjese me parashtrës dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor është deklaruar se janë iniciuar konteste tjera gjyqësore. Të metat e caktuara më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e shkallës së parë e obligon organin e paditur që në ri-procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim, referuar provave në shkresat e lëndës dhe pasi ti mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar edhe pretendimet e të paditurës, po të njëjtat i ka vlerësuar si të pa bazuar nga fakti se ajo me asnjë prove të vetme nuk i ka provuar të njëjtat, kurse ato të ofruara në përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ishin në kundërshtim me gjendjen e konstatuar në këtë shqyrtim gjyqësor.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, bazuar në shkresat e lëndës dhe pas ekzaminimit të aktvendimit, e duke i pasur parasysh edhe pretendimet ankimore, gjen se aktvendimi i kontestuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 nën paragrafi n), dhe nën paragrafi f) dhe nga neni 183 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshme sipas nenit 63 të Ligjit për Konflikte Administrative, pasi që i njëjti është juridikisht i paqartë dhe kundërtënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij, dhe si i tillë është jo i plotë edhe në vërtetimin e gjendjes faktike, për çka në mënyrë të bazuar në ankesë pretendohet, veçanërisht në drejtim të kompetencë lëndore të Gjykatës për të vendosur këtë çështje të anulimit të vendimit.

Meqenëse aktvendimi i ankimuar përmban të meta të tilla të lartcekura, për shkak të te cilave i njëjti nuk mund të shqyrtohet, ngase arsyet e dhëna në të janë të paqarta, sepse Gjykata pas shqyrtimit të padisë, nuk i ka kushtuar vëmendje të duhur parakushteve, përkatësisht prezumimeve procedurale, të cilat duhet të plotësohen, për vlerësimin fillimisht të kompetencës lëndore të Gjykatës për të vendosur lidhur me objektin e kërkesëpadisë se paditëses, e që i referohet, anulimit të vendimit. Pra Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë identifikimin e saktë të natyrës së objektit të kontestit, duke mos bërë kështu përcaktimin e saktë të faktit nëse objekti i kontestit është kompetencë lëndore e Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, apo është çështje që mund të iniciohet konflikti administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Me nenin 17.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, është përcaktuar se “Gjykata sipas detyrës zyrtare, menjëherë pas marrjes së padisë, duhet të konstatojë se a është kompetente për procedimin e çështjes që i është paraqitur. 17.2 Ky vlerësim i kompetencës bëhet në bazë të thënieve në padi dhe në bazë të fakteve që i ka të njohura vetë gjykata”. Ndërsa neni 19, përcakton se “Secila gjykatë gjatë gjithë procedurës së shkallës së parë, sipas detyrës zyrtare kujdeset për kompetencën e vet lëndore”.

Kurse neni 182 paragrafi 2 nën paragrafi f), që i referohet shkeljeve thelbësore të procedurës kontestimore përcakton se “Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë: në çoftë se gjykata ka vendosur për kërkesëpadinë për të cilën është me kompetencë lëndore gjykata më e lartë e llojit të njëjtë, gjykata e llojit tjetër”.

Gjykata e Apelit vlerëson se kompetenca lëndore e Departamentit për Çështje Administrative, është përcaktuar me nenin 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ku është përcaktuar se “Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe

*interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative.*” Ndërsa me nenin 10 par.1 të te njëjtit ligj, është përcaktuar se “*Të drejtë për të nisur konfliktin administrativ ka personi fizik si dhe personi juridik, nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtar në procedurën administrative, i është shkelur ndonjë e drejtë apo interes ligjor.*” Kurse me dispozitën e nenit 15 par.1 pika 1.2 të te njëjtit ligj, i cili rregullon rastet se kur nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ, përcaktohet se “*1. Konflikti administrativ nuk mund të zhvillohet: 1.2. kundër akteve të nxjerra në çështjet rreth të cilave, sipas dispozitës së ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ.*”

Kolegji vlerëson se për të përcaktuar natyrën e një konflikti administrativ nuk mjafton që Gjykata të identifikojë vetëm atë që shkruhet në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë, ajo duhet të shqyrtojë më tej faktet e çështjes dhe pretendimet e palëve. Vetëm pas analizimit me kujdes të statusit të palës paditëse, kërkesës së padisë, të te drejtës subjektive të pretenduar si të shkelur dhe të faktit të paligjshëm që pretendohet ta ketë shkelur këtë të drejtë subjektive, si dhe pas ballafaqimit të tyre me dispozitat e të drejtës objektive, Gjykata mund të arrijë në një përfundim të saktë mbi natyrën e kontestit, se i njëjti a është kontest që bënë pjesë në kompetencën lëndore të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, apo është kontest ndaj të cilit mund të iniciohet konflikti administrativ, në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Duke u bazuar në këto dispozita ligjore, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, sipas vlerësimit të kolegjit të apelit, pa të drejtë ka aprovuar si të bazuar padinë e paditëses, ngase nuk ekziston kompetenca e saj në këtë çështje juridike, pasi që marrëdhënia e punës për paditësen rregullohet me Ligjin e Punës, dhe me pjesën e pestë të Ligjit për Zyrtarët Publikë, që do të thotë se pozita e paditëses nuk është pjesë e nëpunësve të shërbimit civil, sepse me Ligji për Zyrtarët Publik, vetëm nëpunësve të shërbimit civil ju ka dhënë mundësinë që të fillojnë konflikt administrativ në Departamentin për Çështje Administrative, dhe atë pasi ti shtjerrin procedurat e brendshme të ankimimit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Po ashtu edhe me nenin 2 të Ligjit për Zyrtarët Publikë nr.06/L-114, zyrtarët e shërbimit publik nuk konsiderohen nëpunës civil, sepse me këtë nen përcaktohet saktë se “1. Me këtë ligj rregullohet marrëdhënia juridike ndërmjet shtetit dhe zyrtarëve publikë. 2. Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës. 3. Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë. 4. Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. 5. Nëpunës i Kabinetit - është zyrtari publik, që ushtron detyrën në Kabinetin e Presidentit, të Kryetarit të Kuvendit, të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, të Kryeministrit, të Zëvendëskryeministrit, të Ministrit ose të titullarit të një institucioni të pavarur kushtetues dhe të Kryetarit të Komunës. Statusin e nëpunësit të Kabinetit e kanë edhe nëpunësit të cilët ushtrojnë detyrat për nën kryetarin e Kuvendit të Kosovës dhe për grupin parlamentar. 6. Nëpunës administrativo-teknik dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike”.

Kurse neni 74 i këtij ligji, rregullon çështjen e mbrojtjes së nëpunësit të shërbimit publik, ku përcaktohet se “1. Zyrtari i shërbimit publik mund të ankohet te punëdhënësi kur pretendon se i janë shkelur të drejtat në marrëdhënien e punës. Të drejtën e ankimit e kanë dhe kandidatët në procedurën e konkurrimit. 2. Ankimi paraqitet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga njoftimi i vendimit. 3. Shqyrtimi i ankesave është në kompetencën e Komisionit të Ankesave. Komisioni i Ankesave krijohet: 3.1. në çdo administratë të institucionit të shërbimit publik; 3.2. në çdo ministri për administratën e njësisë të Shërbimit Publik në kompetencë të administratës shtetërore; dhe 3.3. në çdo komunë për nëpunësit e administratës së njësisë së shërbimit publik në kompetencë të komunës. 4. Ankesa shqyrtohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga paraqitja e saj. 5. *Ankuesi, nëse nuk është i kënaqur me vendimin e organit të ankimit apo në rast se nuk merr përgjigje brenda afatit të përcaktuar në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni, në afatin vijues prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, mund të iniciojë kontest pune në gjykatën kompetente.* 6. Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton rregullat për krijimin dhe procedurën e punës të Komisionit të Ankesave”.

Sipas vlerësimit të kolegjit të apelit në bazë të paragrafit 5 të nenit 74 Gjykatë kompetente për vendosjen e padisë së ankuesit, është Gjykata Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni për Çështje Civile, fakt ky i konfirmuar edhe me Mendimin Juridik të nxjerrë nga Gjykata Supreme e Kosovës, nr.42/2023, të dt.27.02.2023, kjo për faktin se Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, siç u theksua me lart ka kompetencë lëndore dhe territoriale të vendosë vetëm për kontestet që i referohen nëpunësve të shërbimit civil nga kapitulli (I) të Ligjit për Zyrtarët Publik, e të cilët e kontestojnë vendimin përfundimtar të nxjerrë nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në Prishtinë, organ ky i cili i shqyrton ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve të cilët pretendojnë të punësohen në shërbimin civil të Kosovës.

Po ashtu me dispozitën e nenit 15 par. 1 pika. 1.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative Nr.03/L-202 përcaktohet se Konflikti Administrativ nuk mund të zhvillohet, kundër akteve të nxjerra në çështjet në të cilat është siguruar mbrojtja gjyqësore jashtë konfliktit administrativ”. Ndërsa, paditësja sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në këtë çështje juridike gëzon mbrojtje gjyqësore sipas Ligjit të Punës së Kosovës, dhe se ligjshmëria e vendimit të kontestuar me padi nga paditësja vlerësohet nga Departamenti i Përgjithshëm në procedurë civile-kontestimore. Prandaj, për këto arsye kolegji i apelit vlerëson se Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative nuk është kompetente për të vendosur çështjet juridike, ku palë paditëse janë nëpunësit e shërbimit publik.

Prandaj, mbi këto arsye, pasi që marrëdhënia e punës për këtë pozitë rregullohet me Ligjin e Punës dhe me pjesën e pestë të Ligjit për Zyrtarët Publikë, që do të thotë se objekti i kërkesëpadisë së ankuesve nuk hynë në kategorinë e të drejtave të nëpunësve të shërbimit civil, por hynë në kategorinë e të drejtave të nëpunësve të shërbimit publik, e rrjedhimisht sipas nenit 74 të Ligjit për Zyrtarët Publik, dhe nenit 79 të Ligjit të Punës, të njëjtit gëzojnë mbrojtje gjyqësore jashtë konfliktit administrativ, në Gjykatën Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil.

Për arsyet e lartcekura, aktgjykimi i kundërshtuar është dashtë të priset dhe çështja t’i kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje, për t’i mënjeluar shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës të theksuara më lartë, që janë të tilla që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktgjykimit të goditur.

Në ri-procedurë, Gjykata e shkallës së parë duhet ti mënjanoj të metat e vërejtura sipas këtij aktvendimi, e që i referohen kompetencës lëndore të Gjykatës, përkatësisht shpalljes së saj jo kompetente, dhe pas mënjanimi të tyre, Gjykata e shkallës së parë ka mundësi të merr vendim të drejtë dhe të ligjshëm në kuptim të dispozitave të sipërcituara të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 dhe 63 të Ligjit për Konflikte Administrative, lidhur me nenin 195 paragrafi 1 nën paragrafi c) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
AA.nr.50/2023, datë 05.01.2024

Kryetar i kolegjit  
Ramiz Kuqi